

VENDIM
Nr. 229, datë 30.9.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 99, DATË 16.4.2021,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GERTI’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘VARDARI’ ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1972 kw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.9.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Gerti” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 99, datë 16.4.2021, i ndryshuar me vendimet nr. 208, datë 17.8.2022 dhe nr. 284, datë 25.9.2023, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vendimin nr. 99/2021, i ndryshuar, në pikën 4 është përcaktuar se: “Shoqëria ‘Gerti’ sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së rinovuar me Bashkinë Librazhd, jo më vonë se data 7.8.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.”.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar germen “g”, të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerjeje, kontrata qiramarrjeje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerjeje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, pika 4 e vendimit nr. 99/2021, e cila lidhej me depozitimin e kontratës së qirasë, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe duhet të shfuqizohet.

- Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.

- Për të rivendosur logjikën dhe rendin kronologjik të vendimit, është e nevojshme që pikat 2 dhe 3, të vendimit të riformulohen, duke lidhur detyrimin vetëm me depozitimin e lejes së rinovuar të përdorimit të burimit uhor sipërfaqësor.

- Në përputhje me nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pikat 2, 3 dhe 4, të vendimit nr. 99/2021, duhet të ndryshohen.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet e nevojshme që pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të shfuqizohet.

- Shfuqizimi i pikës 4 dhe riformatimi i pikave 2 dhe 3 shmang pasiguritë ligjore dhe e bën vendimin koherent me praktikën aktuale të licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria “Gerti” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Vardari” brenda datës 23.2.2028.”.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.”.

3. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “FTL” sh.a. dhe “OSSH” sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti